

VENDIM
Nr. 624, datë 29.10.2025

PËR SHPALLJEN E NJË ZONE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E
EKONOMISË MALORE NË BASHKINË PËRMET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” në territorin e Bashkisë Përmet të zonës nr. 1, Njësia Administrative Çarçovë, fshatrat Kanikol dhe Draçovë, me sipërfaqe 2.04 (dy pikë zero katër) km², sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese sipas sistemit KRRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë zonë janë:

- të zhvillimit ekonomik;
- të zhvillimit industrial;
- të zhvillimit turistik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Përmet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



